



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 27 Prot.

Tiranë, më 13.01 2016

VENDIM Nr. 132, datë 22.12.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.15, të datës 22.12.2015, pasi shqyrtoi Raportin e Sondazheve Arkeologjike të kryera nga subjekti "K.A.E.XH." Sh.P.K. në fshatin Qesarat të Tepelenës, në kuadër të **projektit të rrugës Levan-Tepelenë, Loti 2** dhe Relacionin e mbikëqyrjes së këtyre sonazheve, realizuar nga ASHA,

VENDOSI:

- I. Të miratojë Raportin e Sondazheve Arkeologjike të kryera nga subjekti "K.A.E.XH." Sh.P.K. në fshatin Qesarat të Tepelenës, në kuadër të projektit të rrugës Levan-Tepelenë, Loti 2 dhe Relacionin e mbikëqyrjes së këtyre sonazheve, realizuar nga ASHA, duke konfirmuar përfundimin dhe mbylljen e tyre, si dhe marrjen e masave për rehabilitimin e zonës, sipas përcaktimeve të mëposhtme.
- II. Profili i rrugës sipas projektit të sipërpërmendur, në një gjatësi prej 40 m përgjatë shkollës paralel me murin rrethues të saj, duhet të ndryshojë duke gjetur zgjidhjen e duhur teknike në mënyrë që, trupi i rrugës (përfshirë skarpatën) të përfundojë 1m larg faqes së jashtme të murit rrethues të shkollës, me qëllim mosdëmtimin e kësaj zone me potencial arkeologjik, të zbuluar gjatë hapjes së sondazheve arkeologjike.
- III. Objektet arkeologjike të dala gjatë kryerjes së sondazheve, pas përpunimit dhe dokumentimit, të depozitohen pranë DRKK Gjirokastër, shoqëruar me një kopje të dokumentacionit të tyre, në prani të përfaqësuesve të ASHA.
- IV. Gjatë zbatimit të punimeve të mëtejshme të projektit, të realizohet mbikëqyrja arkeologjike nga DRKK Gjirokastër, e cila duhet të depozitohet pranë Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik dokumentacionin për të, duke lidhur më parë akt-marrëveshje tre palëshe me ASHA dhe investitorin, sipas vendimit të KKA Nr. 102, datë 1.09.2015.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E KULTURËS



V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al